



## Minjtë të cilët qëndronin në kokë nga Roald Dahl



Dikur moti jetonte një plak i cili kishte 87 vjet dhe quhej Gjergj. Tërë jetën ai kishte qenë njeri i qetë dhe paqësor. Ai ishte shumë i varfër dhe shumë i lumtur.

Kur Gjergji kuptoi se kishte minj në shtëpinë e tij, kjo gjë nuk e brengosi shumë. Mirëpo, minjtë u shtuan. Filluan t'i pengojnë. Vazhduan të shtohen dhe më në fund erdhi koha kur ai nuk mund ta duronte këtë.

“Kjo është e tepërt”, - tha ai “Kjo me të vërtetë është e tepërt”. Doli nga shtëpia, duke çaluar rrugës deri te një shitore ku bleu ca kurthe për minj, një copë djathë dhe pak ngjitës.

Pasi erdhi në shtëpi, me ngjitës i leu kurthet nga ana e poshtme dhe i ngjiti në tavan. Pastaj, në to me kujdes vuri karrema me copëza djathi dhe i vendosi ashtu që të mos mund të shkëputen.

Atë natë, kur minjtë dolën nga vrimat e tyre, i panë kurthet në tavan dhe menduan se kjo është një shaka e madhe. Lëviznin nëpër dysheme, duke u tallur dhe duke treguar lartë me putrat e tyre dhe qeshnin zëshëm.


Në të vërtetë, kjo ishte mjaft qesharake, kurthe për minj në tavan. Kur mëngjesin tjetër Gjergji zbriti poshtë dhe pa që asnjë mi nuk kishte rënë në kurthe, ai buzëqeshi, dhe nuk tha asgjë.

Ai mori një karrige, vendosi pak ngjitës në pjesët e poshtme të këmbëve të saj dhe e ngjiti përmbys në tavan pranë kurtheve. Të njëjtën gjë e bëri edhe me tavolinën, me televizorin dhe me llambën. Ai i mori të gjitha gjërat që ishin në dysheme dhe i ngjiti në tavan.

Vendosi madje dhe një qilim të vogël. Natën e ardhshme, kur minjtë dolën nga vrimat e tyre, ata ende talleshin me atë që kishin parë natën e kaluar. Por tani, kur panë lartë nga tavani, ata përnjëherë ndërprejnë së qeshuri.

“Oh, moj nënë!” bërtiti njëri prej tyre. “Shikoni atje lartë! Ja ku qenka dyshemeja!”

“E pabesueshme!” bërtiti tjetri. “Por, ne sikur po qëndrojmë në tavan!”



“Filloj të ndjej sesi po më sillet në kokë”- tha një tjetër.

“Krejt gjaku po më hip në kokë” – bërtiti dikush tjetër.

“Kjo është e tmerrshme”- tha një mi më plak me mustaqe të gjata. “Kjo është me të vërtetë e tmerrshme! Ne duhet menjëherë të bëjmë diçka!”

“Unë do të alivanosem nëse do të duhet të qëndroj edhe më tej në kokë.” Bërtiti një mi i ri.

“Edhe unë po ashtu.”

“Nuk mund ta duroj këtë!”

“Na shpëtoni!” “Le të bëjë dikush diçka, shpejt!”

Tanimë të gjithë minjtë filluan të bëhen hysterikë. “E di se ç’ duhet të bëjmë.” Tha miu plak. “Të gjithë do të qëndrojmë në kokë dhe atëherë do të jemi të vendosur drejt!”

Njëzëri, ata të gjithë qëndronin në kokë, dhe pas një kohe të gjatë, njënganjë filluan të alivanosen sepse u kishte rënë gjaku në kokë.

Kur Gjergji zbriti poshtë të nesërmen në mëngjes, dyshemeja ishte mbushur me minj. Ai i mbledhi shpejtë dhe i vendosi të gjithë në një shportë.

Atë që duhet të mbani mend është kjo: se kurdo që t’ju duket se bota është kthyer krejtësisht përmbys, bëni që këmbët tuaja të qëndrojnë fort në tokë.



1. Pse Gjergji dëshiroi të lirohet nga minjtë?
  - A Ai çdo herë i i urrente minjtë
  - B Kishte shumë minj.
  - C Ata qeshnin me shumë zë.
  - Ç Ata ia hanin tërë djathin.
  
2. Ku i vuri Gjergji kurthet e minjve?
  - A Në shportë
  - B Afër vrimave të minjve
  - C Nën karrige
  - Ç Në tavan
  
3. Pse minjtë e ngacmonin njëri tjetrin dhe po tregonin lartë me putrat e tyre kur dolën nga vrimat natën e pare?
  - A Ata po e shihnin karrigen në tavan.
  - B Menduan se Gjergji kishte bërë një marrëzi.
  - C Ata donin djathin që ishte në kruthe.
  - Ç Ata ishin të frikësuar nga ajo që panë.

4. Pse buzëqeshi Gjergji kur pa se nuk kishte minj në kurthet?



---

---

①  
②  
③  
④  
⑤  
⑥  
⑦  
⑧  
⑨

5. Ç'bëri Gjergji pasi e ngjiti karrigen në tavan?

- A Buzëqeshi dhe nuk tha asgjë
- B Bleu disa kurthe
- C Ngjiti çdo gjë në tavan
- Ç U dha minjve pak djathë

6. Natën e dytë, ku mendonin minjtë se ishin duke qëndruar dhe cfarë vendosën të ndërmarrin në lidhje me këtë?



---

---

---

---

---

①  
②  
③  
④  
⑤  
⑥  
⑦  
⑧  
⑨

7. Gjejë dhe përshkruaj **një** fjali që tregon panikun të cilën mijtë e ndjenë natën e dytë.



---

---

①  
②  
③  
④  
⑤  
⑥  
⑦  
⑧  
⑨

8. Si të tregon tregimi se ç'mendonin minjtë se po ndodh?

- A Duke të treguar atë që Gjergji mendonte për minjtë
- B Duke përshkruar se ku jetonin minjtë
- C Duke të treguar se ç'i thonin minjtë njëri - tjetrit
- Ç Duke i përshkruar se si ishin minjtë

9. Pse ishte dyshemeja e mbushur me minj kur Gjergji zbriti mëngjesin e fundit?

- A Minjtë kishin qëndruar në kokë tepër gjatë.
- B Gjergji i'u kishte dhënë minjve tepër djathë.
- C Minjtë kishin rënë nga tavani.
- Ç Gjergji kishte vënë ngjitës në dysheme.

10. Ku i vendosi minjtë Gjergji pasi i mbledhi nga dyshemeja?



\_\_\_\_\_

- 1
- 0
- 8
- 9

11. A mendoni se ishte lehtë të mashtrohen minjtë? Trego **një** arsye pse ishte ose pse nuk ishte lehtë të mashtrohen minjtë?



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- 1
- 0
- 8
- 9

12. Ti e kuptove se çfarë njeriu është Gjergji nga ajo që bën. Përshkruaje si është ai dhe përmendi dy shembuj se çfarë bën Gjergji, të cilët tregojnë këtë.



---

---

---

---

---

---

---

- ③
- ②
- ①
- ①
- ⑧
- ⑨

13. Cilat fjalë më së miri e sqarojnë këtë tregim?

- A Serioz dhe pikëllues
- B I frikshëm dhe emocionues
- C Qesharak dhe edukativ
- Ç Emocionues dhe misterioz

14. Mendo për atë se çfarë bënin Gjergji dhe minjtë në këtë tregim. Sqaro se çka e bën këtë tregim të jetë i mahnitshëm.



---

---

---

---

- ①
- ①
- ⑧
- ⑨

## UDHËZIM PËR VLERËSIMIN E AJTEMËVE ME ALTERNATIVA

Ajtemi 1: **B**

Ajtemi 2: **Ç**

Ajtemi 3: **B**

Ajtemi 5: **C**

Ajtemi 8: **C**

Ajtemi 9: **A**

Ajtemi 13: **C**

## UDHËZIM PËR VLERËSIMIN E AJTEMËVE TË HAPUR

### **AJTEMI 4: Pse Gjergji buzëqeshi kur pa që nuk ka minj në kurthe?**

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>1 – Përgjigje e pranueshme</b>	
Përgjigjet përmbajnë interpretim adekuat të reaksionit të Gjergjit në kontekst të tërë tregimit.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë që Gjergji nuk ka qenë i befasuar nga kurthet e zbrazëta. Ata mund të përmbajnë përshkrimin e qëllimit të Gjergjit të zbatojë një plan shumë më të mirë për t'i kapur minjtë.	
<i>Shembuj:</i>	
Ai kishte plan që t'i mashtrojë minjtë dhe të lirohet prej tyre. Sepse ai kishte diçka tjetër në mendje për to. Ose, ata mund të demonstrojnë kompetencë që ai ka dashur vetëm t'i mashtrojë minjtë, por jo edhe për t'i kapur natën e parë.	
<i>Shembuj:</i>	
Ai e dinte që ata nuk do ta marrin djathin natën e parë. Ai i mashtroi minjtë duke i lënë të mendojnë se është budalla.	
<b>0 – Përgjigje e papranueshme</b>	
Përgjigjet nuk përmbajnë interpretim adekuat të reaksionit të Gjergjit në kontekst të tërë tregimit.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet nuk demonstrojnë kompetencë që Gjergji nuk ka qenë i befasuar nga kurthet e zbrazëta ose që ka pasur për qëllim të zbatojë një plan shumë më të mirë për t'i kapur minjtë. Përgjigjet mund të përmbajnë reaksionin e tij pa mos përmbajtur një interpretim adekuat për këtë.	
<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.



## AJTEMI 6: Natën e dytë, ku mendonin minjtë se qëndrojnë dhe çfarë vendosën të bënin në lidhje me këtë?

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>2 – Kompetencë e plotë</b>	
Përgjigjet i ndërlidhin informacionet prej pjesëve të ndryshme të tekstit që të demonstrojnë kompetencë të plotë rreth asaj se si kanë reaguar minjtë.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet përfshijnë prova për të dy elementet që kërkohen nga pyetja: minjtë kanë menduar se qëndrojnë në tavan (ose kanë menduar që tavani është dysheme, ose kanë menduar se janë të përmbysur); dhe minjtë kanë vendosur të qëndrojnë në kokë.	
<i>Shembuj:</i>	
Ata kanë menduar se janë në tavan sepse gjithçka ishte e përmbysur. Ata qëndruan në kokat e tyre.	
Minjtë kanë menduar se tavani është dysheme. Ata kanë qëndruar në kokat e tyre sepse kanë menduar se ashtu do të jenë të vendosur në mënyrë të drejtë.	
<b>1 – Kompetencë e pjesshme</b>	
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të pjesshme mbi atë se si kanë reaguar minjtë.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet përfshijnë prova vetëm për njërin prej elementeve që kërkohen nga pyetja: minjtë kanë menduar se ata qëndrojnë në tavan (ose kanë menduar që tavani është dysheme, ose kanë menduar se janë të përmbysur) dhe minjtë kanë vendosur të qëndrojnë në kokë.	
<i>Shembuj:</i>	
Ata kanë vendosur të qëndrojnë në kokat e tyre.	
Ata kanë menduar se qëndrojnë në tavan kanë kërkuar që t'i shpëtojë dikush shpejt.	
<b>0 – Nuk ka kompetencë</b>	
Përgjigjet nuk demonstrojnë kompetencë mbi atë se si kanë reaguar minjtë.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet nuk përfshijnë prova për asnjërin prej elementeve që kërkohen nga pyetja minjtë kanë menduar se qëndrojnë në tavan (ose kanë menduar që tavani është dysheme, ose kanë menduar se janë të përmbysur); dhe minjtë kanë vendosur të qëndrojnë në kokë.	

<b>Shifrat për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

## AJTEMI 7: Gjeje dhe kopjoje një fjali e cila e tregon panikun që minjtë e kanë ndjerë natën e dytë.

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Nxjerrje e konkludimeve të drejtpërdrejta

<b>1 – Përgjigje të pranueshme</b>
Përgjigjet përmbajnë fjali adekuate e cila e tregon panikun që minjtë e kanë ndjerë. <i>Prova:</i> Përgjigjet përfshijnë së paku një fjali nga të përmendurat më poshtë. Gabime të vogla në kopjim mund të tolerohen në qoftë se nuk e ndryshojnë kuptimin e fjalisë.
<b>0 – Përgjigje të papranueshme</b>
Përgjigjet nuk përmbajnë fjali adekuate e cila e tregon panikun që minjtë e kanë ndjerë. <i>Prova:</i> Përgjigjet nuk përfshijnë asnjë fjali nga të përmendurat më poshtë. Ose, ata mund të përmbajnë vetëm fjali të pasakta nga tregimi nga të cilat nuk mund asgjë të konkludohet mbi panikun e minjve.

<b>Fjali adekuate nga teksti që e tregojnë panikun që e kanë ndjerë minjtë.</b>
<i>Shënim për vlerësuesit:</i> Në qoftë se nxënësi nuk e ka kopjuar tërë fjalinë, pjesën që ka kopjuar duhet të përmbajë mjaftueshëm fjalë që të jetë e qartë që ajo është pjesë e fjalive të përmendura.  Do të alivanosem në qoftë se do të duhet të vazhdoj të qëndroj në kokë! Nuk mund ta duroj këtë! Na shpëtoni! Le të bëjë dikush diçka, shpejt! Tani të gjithë kanë nisur të bëhen hysterikë. Kjo është e tmerrshme! Oh, moj nënë! Shikoni atje lartë! Ja dyshemeja! Por, ne sikur po qëndrojmë në tavan! Filloj të ndjej sesi po më silllet në kokë. Tërë gjaku më ka rënë në kokë. Duhet menjëherë të bëjmë diçka! Ata përnjëherë ndaluan së qeshuri.

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

## **AJTEMI 10: Ku i ka vendosur Gjergji minjtë kur i ka mbledhur nga dysHEMEJA?**

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Dallimi dhe zbulimi i informacioneve dhe mendimeve të dhëna eksplicite

<b>1- Përgjigje të pranueshme</b>	
Përgjigjet e definojnë saktë aktivitetin që është ndërmarrë nga Gjergji, e që përmbahet në mënyrë eksplicite në tekst. <i>Prova:</i> Përgjigjet përmbajnë deklaratë që Gjergji i ka vendosur minjtë në shportë.	
<b>0 – Përgjigje të papranueshme</b>	
Përgjigjet e definojnë pasaktë aktivitetin që është ndërmarrë nga Gjergji, e që përmbahet në mënyrë eksplicite në tekst. <i>Prova:</i> Përgjigjet nuk përmbajnë deklaratë që Gjergji i ka vendosur minjtë në shportë. Ato mund të përmbajnë supozime për aktivitet e Gjergjit pasi i ka vendosur minjtë në shportë, ose informacione joadekuate nga teksti.	
<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

**AJTEMI 11: A mendon se është lehtë të mashtrohen minjtë? Shkruaj një shkak pse është lehtë ose pse nuk është lehtë.**

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<b>1 – Përgjigje të pranueshme</b>	
Përgjigjet demonstrojnë interpretim të besueshëm të tipareve të minjve përmes mbështetjes së bazuar adekuate tekstuale të interpretimit.	
<u>Prova:</u>	
Përgjigjet përmbajnë po ose jo, ose janë të papërcaktuara mbi atë se a është lehtë t’i mashtrosh minjtë. Mirëpo, përgjigjet duhet të përmbajnë edhe shkakun, si mbështetje të mendimit, i cili bazohet në tekstin. Shkaku përfshin informacione nga teksti që të na tregojë se sa lehtë ose vështirë është të mashtrohen minjtë.	
(Mbani mend që informacioni i njëjtë nga teksti mund të përdoret për mbështetje edhe të mendimit “po” edhe “jo”.)	
<u>Shembuj:</u>	
Po, sepse kanë menduar se qëndrojnë në tavan.	
Jo, Gjergji doemos është dashur të ngjis të gjitha orenditë në tavan që t’i mashtrojë.	
Po, ai duhej të bëjë shumë për t’i kapur ata.	
Jo, ishin të nevojshme vetëm 2 netë për t’i kapur.	
Po, ai harxhoi 2 netë për t’i kapur ata.	
<b>0 – Përgjigje të papranueshme</b>	
Përgjigjet nuk demonstrojnë interpretim bindës të tipareve të minjve.	
<u>Prova:</u>	
Përgjigjet përmbajnë po ose jo, ose janë të papërcaktuara mbi atë se a është lehtë t’i mashtrosh minjtë. Mirëpo, përgjigjet nuk e përmbajnë shkakun, si mbështetje të mendimit, i cili bazohet në tekstin. Ata mund të përmbajnë informacione joadekuate nga teksti të cilat nuk i referohen tekstit.	

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

**AJTEMI 12: Ti mësove se çfarë njeriu është Gjergji nga ajo që ai e bën. Përshkruaje si është ai dhe përmendi dy shembuj që bën Gjergji, që e tregojnë këtë.**

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Integrimi dhe interpretimi i ideve dhe informacioneve

<p><b>3 – Kompetencë gjithëpërfshirëse</b></p> <p>Përgjigjet demonstrojnë kompetencë gjithëpërfshirëse e cila është rezultat i integritit të ideve të tekstit që të interpretohet karakteri i Gjergjit.</p> <p><u>Prova:</u></p> <p>Përgjigjet përshkruajnë një ose më shumë tipare të karakterit që janë të lidhura me ngjarjen kryesore në tekst (Gjergji i mashtroi minjtë ose Gjergji u lirua prej tyre).</p> <p>Në mënyrë plotësuese, përgjigjet përmbajnë më së paku dy shembuj të aktiviteteve të Gjergjit të cilët janë provë e tipareve të karakterit të tij (Në qoftë se përgjigjja përshkruan dy tipare të karakterit të tij, nga një shembull për secilin tipar është i mjaftueshëm.)</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <p>Ai është i mençur sepse i la minjtë derisa nuk u bënë shumë, pastaj gjeti mënyrë që t’i hutojë minjtë. Ai nuk dëshironte që ata të vdesin me vdekje të tmerrshme. Kjo do të thotë se ai mendon për të tjerët.</p> <p>Gjergji është i zgjuar sepse i ngjiti kurthet në tavan natën e parë që t’i detyrojë minjtë të mendojnë se ai është budalla. Pastaj, ai i ngjiti orenditë në tavan që ata të mendojnë se qëndrojnë me kokën poshtë.</p>
<p><b>2 – Kompetencë e kënaqshme</b></p> <p>Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të kënaqshme e cila është rezultat i interpretimit të karakterit të Gjergjit me mbështetje tekstuale adekuate.</p> <p><u>Prova:</u></p> <p>Përgjigjet përfshijnë një tipar të karakterit e cila është e lidhur me ngjarjen kryesore në tekst (Gjergji i mashtroi minjtë ose Gjergji u lirua prej tyre).</p> <p>Në mënyrë plotësuese, përgjigjja përmban një shembull të aktivitetit të Gjergjit i cili është provë e tiparit të karakterit të tij.</p> <p><u>Shembull:</u></p> <p>Gjergji është i jashtëzakonshëm sepse shpiku një mënyrë të mençur për t’i zënë minjtë.</p>
<p><b>1 - Kompetencë minimale</b></p> <p>Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të kufizuar të karakterit të Gjergjit.</p> <p><u>Prova:</u></p> <p>Përgjigjet përshkruajnë një tipar të karakterit i cili është i lidhur me ngjarjen kryesore në tekst (Gjergji i mashtroi minjtë ose Gjergji u lirua prej tyre).</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <p>Gjergji është i mençur.</p> <p>Ai është shumë njeri i zgjuar.</p> <p>Ose, përgjigjet përshkruajnë një tipar të karakterit i cili nuk është i lidhur me ngjarjen kryesore në tekst dhe përmban mbështetje tekstuale.</p> <p><u>Shembuj:</u></p> <p>Njeri plak i lumtur dhe i këndshëm sepse i la minjtë të jetojnë në shtëpi.</p>

**AJTEMI 12: Ti mësove se çfarë njeriu është Gjergji nga ajo që ai e bën. Përshkruaje si është ai dhe përmendi dy shembuj që bën Gjergji, që e tregon këtë.**  
*(vazhdon)*

<b>0 – Kompetencë jo e kënaqshme</b>	
Përgjigjet demonstrojnë kompetencë të pamjaftueshme të karakterit të Gjergjit.	
<i>Prova:</i>	
Përgjigjet nuk përmbajnë përshkrim adekuat ose të saktë të Gjergjit.	
Ose, përshkrimi i Gjergjit mund të jetë aq i paqartë dhe i përgjithësuar kështu që është evidente që krejtësisht pak ose aspak nuk ka kompetencë të tregimit.	
Ose, përgjigjet mund të përfshijnë vetëm karakteristikat fizike.	
Ose, përgjigjet mund të përfshijnë disa informacione nga tregimi, mirëpo që nuk janë të lidhura me përshkrimin e karakterit të Gjergjit.	
<i>Shembuj:</i>	
Ai nuk është shumë i mençur.	
Ai është i këndshëm.	
Gjergji është njeri plak.	
Ai më në fund i kapi minjtë.	
Ai është i lumtur dhe i varfër.	

<b>Shifra për mungesë përgjigjesh</b>	
<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.

**AJTEMI 14: Mendo se çfarë kanë bërë Gjergji dhe minjtë në tregim. Sqaroje se çfarë e bën atë të pabesueshme.**

Qëllimi: Letërsi

Procesi: Analizë dhe vlerësimi i përmbajtjes, gjuhës dhe elementeve tekstuale

**2 – Kompetencë e plotë**

Përgjigjet përmbajnë vlerësimin e plotë të gjasës së ngjarjeve ose protagonistëve në tregim.

Prova:

Përgjigjet përshkruajnë një aspekt nga ngjarjet e poshtëshënuara ose protagonistët e tregimit. Po ashtu, përgjigjet duhet të përmbajnë sqarim të tërësishëm se përse ngjarjet ose tiparet e protagonistëve nuk janë të mundshme në jetën e vërtetë.

Shembuj:

Minjtë po flisnin mes veti në tregim. Kjo nuk është e mundur sepse minjtë nuk flasin si njerëzit. Kur Gjergji i ngjiti të gjitha orenditë të tavan, kjo ishte e pamundur. Askush nuk mund të ta bëjë këtë sepse ngjitësi nuk është aq i fortë.

Ose, përgjigjet përshkruajnë dy aspekte nga ngjarjet e shkruara më poshtë ose protagonistët e tregimit. Sqarime mundet, por edhe nuk është me patjetër të përfshihen.

Shembuj:

Ai i ka ngjitur të gjitha orenditë të tavan. Edhe minjtë kanë mundur të flasin.

**1 – Kompetencë e pjesshme**

Përgjigjet përmbajnë vlerësim të pjesshëm të gjasës së ngjarjeve ose protagonistëve në tregim.

Prova:

Përgjigjet përshkruajnë një aspekt nga ngjarjet e poshtëshënuara ose protagonistët e tregimit. Mirëpo përgjigjet nuk përmbajnë sqarim se përse ngjarjet ose tiparet e protagonistëve janë të pamundshme, ose sqarimet përmbajnë deklarata se kjo thjeshtë është e pamundur.

Shembuj:

Minjtë kanë folur.

Minjtë kanë bërë shaka, kjo është e pamundur.

Ose, përgjigjet përmbajnë sqarim, mirëpo pa përshkrimin e elementit të tregimit që po vlerësohet.

Shembuj:

Njerëzit nuk bëjnë ashtu me orenditë.

**0- Nuk ka kompetencë**

Përgjigjet nuk përmbajnë vlerësimin e gjasës së ngjarjeve ose protagonistëve në tregim.

Prova:

Përgjigjet nuk përshkruajnë asnjë nga aspektet e ngjarjeve ose protagonistëve në tregim të cilët janë dhënë më poshtë dhe nuk përmbajnë sqarim të qëndrueshëm mbi atë se çfarë e bën tregimin të jetë i pamundur. Ata mund të përmbajnë deklarata nga përmbajtja e tregimit, por deklaratë që nuk mund të merren parasysh si provë për atë që e bën tregimin të pabesueshëm sepse nuk përmbajnë sqarime plotësuese. Ose, përgjigjet mund të jenë deklarata që tregimi është apo nuk është i mundur.

Shembuj:

Ai ka kapur minj.

Kjo është mahnitëse.

**AJTEMI 14: Mendo se çfarë kanë bërë Gjergji dhe minjtë në tregim. Sqaroje se çfarë e bën atë të pabesueshëm.**  
*(vazhdon)*

**Elementet mahnitëse në tregim.**

**Ngjarje:**

Ngjitja e orendive në tavan.

Të kaluarit nëpër aq fatkeqësi që të kapen minjtë.

Minjtë ishin të mashtruar.

Minj të alivanosur.

**Protagonistë:**

Minj që flasin.

Minj që qëndrojnë në kokë.

Minj që mendojnë se janë të përmbysur.

Minj që bëhen hysterikë.

Minj që qeshen dhe bëjnë shaka.

*Shënim për vlerësuesit:* Disa nxënës mund ta sqarojnë dallimin mes natyrës joreale të karakterit të Gjergjit dhe aktiviteteve të tij. Në qoftë se përgjigjja mbështetet me informacione nga tregimi mund të pranohet.

**Shifra për mungesë përgjigjesh**

<b>8</b>	Pyetja nuk është në test, mungon ajo faqe e testit ose ndonjë shkak tjetër i cili nuk varet nga nxënësi.
<b>9</b>	Nuk ka përgjigje.